



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**TIRANË**

**Nr. 932 Akti**                      **Nr. 398 Vendimi**  
**Dt.regj.03.02.2022**              **Dt. 21.02.2022**

**VENDIM**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga

**GJYQTAR SOKOL TONA**

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Znj.Dasantila BEJKO**, me pjesëmarrjen e prokurore **Znj.Anisa Qilimi**, sot më dt. **21 Shkurt 2022** perfundoj se shqyrtuari çeshtjen penale me nr. 964/932 Akti qe i perket:

**I PANDEHUR:** Ilirjan Ahmetaj identifikuar me karte identiteti me nr.K 11226026 E, i biri i Haxhi dhe i Luljeta i dt 26.12.2001 lindur dhe banues ne Tirane

fshati Shpat banese private pa nr.Baldushk, arsim 9 klase, i padenuar, beqar, me shtetesi shqiptare, mbrojtur ne gjykim nga avokat Z. Selim Nelaj me nr. 4639 Liçense dhe Nipt L 22310013 M.

**Akuzuar:**  Për kryerjen e vepres penale të “Kultivimit te bimeve narkotike”

**Parashikuar :** Nga Neni 284/1 te Kodit Penal.

Gjykata pasi dëgjoi pretendimet e palëve;

Si degjoj prokuroren e cila ne perfundim kerkoj;

-Deklarimin fajtor te te pandehurit Ilirjan Ahmetaj per kryerjen e vepres penale te “Kultivimit te bimeve narkotike”parashikuar nga Neni 284/1 i Kodit Penal dhe denimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.

-Sugjerimin e aplikimit te gjykimit te shkurtuar.

-Ne zbatim te Nenit 59 te Kodit Penale urdheohet pezullimi i ekzekutimit te denimit me burgim per pjesen e mbetur pa vuajtur te denimit, duke e vene ne prove te pandehurin per nje periudhe kohe prej 4 (kater) vjetesh me kusht dhe qe gjate kesaj periudhe te detyrohet te mbaje kontakte me sherbimin e proves dhe te mos te kryej veper tjeter penale.

Prova materiale sekuestruar te pandehurit te asgjesohet dhe kthimin e sendit personal te pandehurit.

-Shpenzimet proceduriale ne ngarkim te te pandehurit.

Si degjoj avokatin e te pandehurit i cili kerkoj:

-Nje mase me te bute denimi, duke aplikuar Nenin 59 te Kodit Penal, ndihet i penduar, kerkoj meshire nga gjykata.

-I pandehuri Ilirjan Ahmetaj shprehet dakort me avokatin e tij.

Si shqyrtoi provat dhe çështjen në tërësi:

### **VËREN**

Ne kete Gjykate, eshte sjelle per gjykim procedimi penal nr.932 Akti date 03.02.2022 me kërkuar Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane ne ngarkim te te pandehurit Ilirjan Ahmetaj i akuzuar per kryerjen e veprës penale te “Kultivimit te bimeve narkotike” parashikuar nga Neni 284/1 i Kodit Penal.

Gjate shqyrtimit gjyqesor te kesaj çështje ne prani te palëve, organi i akuzes duke pretenduar ne fajesine e te pandehurit ne lidhje me kryerjen prej tij te vepres penale te percaktuar si me siper si edhe duke kerkuar deklarimin fajtor dhe denimin e tij -ai organ- i parashtroj kesaj gjykate sa vijon:

I pandehuri Ilirjan Ahmetaj, eshte banor i periferisë se qytetit te Tiranës dhe pa precedent penal te mepareshem. I pandehuri ka qene ndodhur ne masën e sigurisë “Arrest ne burg” tashme i ndodhur ne masën e sigurisë “Arrest ne shtëpi”, i akuzuar per kryerjen e veprës penale e cila rezultoi te kete ndodhur ne rrethanat si vijon:

Mbi bazen e informacioneve te siguruar ne rruge konfidenciale, sherbimet policore te Komisarariatit te Policise Nr.1 ne Kryeqytet, jane vene ne dijeni se ne nje siperfaqe toke qe ndodhej ne Fshatin Shpat -Njesia administrative- Baldushk, ne vendin e quajtur Pishat ndodheshin bime te mbjella te cilat dyshoheshin si bime narkotike, te llojit Cannabis Sattiva.

Per kete qellim nga ana e forcave policore jane organizuar sherbimet per identifikimin dhe kapjen e personit qe kultivonte kete bime ne parcelen e sipercituar.

Keshtu ne daten 24.07.2021, rreth oreve te mbremjes me nderhyrjen e forcave policore, eshte mundesuar te identifikohen 59 rrenje bime te mbjella nga shtetasi Ilirjan Ahmetaj, te vendosura ne distance 1 meter nga njera-tjetra , me lartesi 10-50 cm si edhe ne faze lulezimi, te cilat dyshoheshin si bime narkotike, te llojit Cannabis Sattiva.

Pas sekuestrimit dhe nenshtrimit te aktit te ekspertimit kimik nr. 8913 date 13.09.2021 te bimeve te sekuestruara nga siperfaqja e mbjelle ka rezultuar se lenda e sekuestruar eshte Cannabis Sattiva ne fazen e lulezimit, e cila ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7975 date 26.07.95 “Per barnat narkotike dhe psikotrope”, ajo ben pjese ne lendet narkotike.

Sipas kqyrjes se akteve te pronesise se tokes ku lulezonin bimet narkotike te mesiperme, eshte konstatuar se ajo siperfaqe toke rezulton toke ne pronesi te shtetit.

Mbi konstatimin e faktit penal te mesiperme, si edhe kryerjen e veprimeve hetimore dhe proceduriale, organi akuzes ka filluar çështjen penale ne ngarkim te te pandehurit Ilirjan Ahmetaj duke e akuzuar ate per kryerjen e vepres penale siç pershkruhet ne pjesen hyrese te ketij vendimi.

Ne lidhje me fajesine e te pandehurit per vepren per te cilen ai akuzohet si edhe me kualifikimin juridik te saj, gjykata çmon se organi i akuzes i ka vleresuar drejt ato.

Keshtu, ne drejtim te fajesise se te pandehurit hedhin drite prova te tilla si:

-Proçes verbali i këqyrjes se vendit te ngjarjes i shoqëruar me tabelen fotografike përkatëse date 24.07.2021;

-proçes verbali i sekuestrimit te proves materiale date 24.07.2021;

-raporti i sherbimit policor i mbajtur nga punonjesit e policise me pershkrimin e ngjarjes si me siper.

-Akt ekspertimi kimik nr.8913 date 13.09.2021 nga përmbajtja e te cilit gjykata behet me dije se bimet e sekuestruara nga siperfaqja e mbjelle jane bime narkotike, Cannabis Sattiva ne fazen e lulezimit, e cila ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7975 date 26.07.95 “Per barnat narkotike dhe psikotrope”, ajo bime ben pjese ne lendet narkotike.

Pervec provave shkresore, organi i akuzes paraqiti edhe deklarimet e shtetasve Haxhi Ahmetaj dhe Niko Ahmetaj.

Po keshtu, gjykata u njoh edhe me deklarimet e vete te pandehurit Ilirjan Ahmetaj i cili ne séance gjyqesore, ai duke u treguar i penduar si edhe duke pohuar se ai e ka kryer vepren penale i ndikuar kushtet shume te vështira ekonomike te familjes se tij, duke i blere fidanët e bimëve narkotike ne Tirane tek persona te panjohur, ai duke pranuar ne te njejten kohe dhe vlerën e akteve ai i kerkoj kesaj gjykate proçedimin e tij me gjykim te shkurtuar kerkese te cilen gjykata me vendim te ndermjetem e pranoi.

Edhe per sa i takon kualifikimit ligjor te vepres gjykata çmon se organi i akuzes e ka vleresuar drejt ate, pasi ne rastin ne gjykim çmohet se ne veprimet e te pandehurit Ilirjan Ahmetaj ekzistojne elementet perberes te figures se vepres penale te “Kultivimit te bimeve narkotike”, parashikuar nga Neni 284/1 i Kodit Penal, per te cilen ai akuzohet, si ata qe lidhen me objektin dhe anen objektive te vepres penale, ashtu edhe ata qe lidhen me subjektin dhe anen subjektive te saj.

Ne lidhje me caktimin e llojit dhe te mases se denimit gjykata mban parasysht rrezikshmerine shoqerore te vepres penale te kryer nga i pandehuri, raportet shoqerore qe ajo cenon, te vendosura ne mbrojtje te rendit dhe sigurise publike dhe te jetes e shendetit te personit, si edhe veçanerisht perhapjen e kesaj vepre penale.

Po keshtu gjykata vlereson edhe rrezikshmerine e te pandehurit veçanerisht ne faktin e kryerjes prej tij te nje vepre penale me dashje te drejtperdrejte.

Ne kete gjykim gjykata identifikon edhe disa rrethana lehtesuese te cilet i vlereson te tilla, ne kuptim te kriterëve te vendosura ne Ligjvënesi ne Nenet 48 dhe 49 te Kodit Penal.

Keshtu, gjykata veçon pendimin e thelle te te pandehurit, aresyet e tij ekonomike, familjare dhe sociale te dokumentuara kësaj gjykate; si edhe faktin qe i pandehuri Ilirjan Ahmetaj figuron pa precedente penal te mepareshem.

Pikerisht, per ekzistencën e rrethanave te tilla gjykata vlerëson te drejte qëndrimin e organit te akuzes dhe ne përputhje me qëllimin e dënimit, caktimin e nje dënimi me kusht ndaj te pandehurit Ilirjan Ahmetaj, ne lidhje me pezullimin e ekzekutimit te dënimit me burgim, per pjesën e mbetur te pavuajtur, siç do te përcaktohet ne dispozitivin e këtij vendimi.

Ne kete konkluzion gjykata arrin pasi ne caktimin e llojit dhe te masës se dënimit çmohet se denimi i te pandehurit duhet te jete ne perputhje me kriteret e vendosura nga Ligjvënesi ne Nenin 47 të Kodit Penal ne te cilen është përcaktuar se: “...në caktimin e dënimit ndaj personit gjykata merr parasysht rrezikshmërinë e vepres penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese”.

Në këtë dispozitë është shprehur parimi i individualizimit të dënimit i cili është një nga parimet themelore që udhëheq gjykatën në caktimin e dënimit, duke vlerësuar ne kete menyre se

respektimi i këtij parimi themelor në caktimin e masës konkrete të dënimit përbën garanci për mbrojtjen e interesave të shtetit dhe interesave të ligjeshme të shtetasve.

**PËR KËTO ARËSYE**

**Gjykata bazuar ne Nenet 384, 390 dhe 190 te Kodit Proçedures Penale**

**VENDOSI**

-Deklarimin fajtor te te pandehurit **Ilirjan Haxhi Ahmetaj** per kryerjen e vepres penale te «Kultivimit te bimeve narkotike» dhe ne baze te Nenit 284/1 te Kodit Penal e denon ate 3 (tre) vjet burgim.

-Ne baze te Nenit 406 te Kodit Proçedures Penale mbas uljes se denimit me 1/3 i pandehuri **Ilirjan Haxhi Ahmetaj** denohet me 2 (dy) vjet burgim.

-Ne zbatim te Nenit 59 te Kodit Penal (te ndryshuar me Ligjin 36/2017 dt. 30.03.2017, Neni 3/3), Gjykata urdheron pezullimin e ekzekutimit te vendimit te denimit me burgim per pjesen e mbetur pa vuajtur, duke e vene ne prove te pandehurin per nje periudhe kohe prej 3 (tre) vjtesh me kusht qe ai te mbaje kontakte me Zyren Vendore te Sherbimit te Proves Tirane dhe brenda kesaj periudhe te mos kryej veper tjeter penale, duke filluar ky afat nga e nesermja e shpalljes se ketij vendimi.

-Bazuar ne Nenin 261/b i Kodit Proçedures Penale Gjykata urdheron heqjen e mases se sigurimit «**Arrest ne shtepi**» marre prej te pandehurit **Ilirjan Haxhi Ahmetaj** me vendimin nr. 697 Akti dt. 10.08.2021 te Gjykates se Apelit Tirane.

Prova materiale sekuestruar te pandehurit sipas proçesverbalit dt. 24.07.2021:

-Lenda narkotike e llojit «Cannabis Sattiva» sasia prej 59 (pesedhjete e nente) bime te asgjesohet.

-Nje telefon Iphone 6 me ngjyre gri me nr.IMEI 35667808195926 dhe nr.telefoni 0692955114, t`i kthehet shtetasit **Ilirjan Haxhi Ahmetaj**.

-Shpenzimet proçeduriale te kryera ne fazen e hetimeve paraprake si edhe ato gjyqesore i ngarkohen te pandehurit.

-Kunder vendimit lejohet ankim brenda 15 (pesembedhjete) diteve nga e nesermja e njoftimit.

**U shpall sot, në Tiranë më date 21 Shkurt 2022.**

**SEKRETARE**

**GJYQTAR**

**Dasantila BEJKO**

**SOKOL TONA**

Shpenzime proçeduriale	5.000 lek
Njoftime	150 lek